

V E N D I M
Nr.314, datë 15.5.2003

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË,
MINISTRISË SË RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE TË TURIZMIT DHE
SHOQËRISË AQUAMUNDO, GMBH PËR ADMINISTRIMIN E NDËRMARRJES SË
UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE-SHA KAVAJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” dhe të neneve 10 pika 3/I/a e 72, pika 5/I/a të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Kontratës ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe shoqërisë AquaMundo GmbH për administrimin e ndërmarrjes së ujësjellës-kanalizimeve sh.a.-Kavajë.

2. Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, me cilësinë e organit shtetëror të autorizuar, t’i transferojnë bashkisë së Kavajës të drejtën e përfaqësimit të pronarit për pronën shtetërore, nëpërmjet akteve ligjore të dorëzimit.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

KONTRATË

**MENAXHIMI PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE NË ZONËN E SHËRBIMIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIME SHA KAVAJË,
SHQIPËRI NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË TË PËRFAQËSUAR
NGA ORGANI SHTETËROR I AUTORIZUAR (PUNËDHËNËSI) DHE AQUAMUNDO GMBH
KONTRAKTORI MENAXHUES**

Kjo Kontratë menaxhimi “Kontrata” u lidh sot më 23 dhjetor 2002, me afat katër vjet, ndërmjet Qeverisë shqiptare, të përfaqësuar nga organi shtetëror i autorizuar, që më poshtë do të quhet “Punëdhënësi”, në dobinë e UK Kavajë sh.a., një ndërmarrje ujësjellës-kanalizime “Përfituesi”, e cila është e themeluar në përputhje me ligjin shqiptar, përkatësisht ligji nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, ligji nr.7973, datë 26.7.1995 “Për shndërrimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, dhe ligjit nr.8103, datë 28.3.1996 “Për privatizimin e ndërmarrjeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve”, me seli në Kavajë dhe me aksioner të vetëm shtetin shqiptar, të përfaqësuar nga Këshilli i saj Mbikëqyrës

dhe

AquaMundo GmbH – një shoqëri e themeluar në përputhje me ligjet e Republikës Federale Gjermane, që vepron në emër të saj, me seli në Richard Wagner Str. 75, D-68165 Mannheim, Federal Republic of Germany, që më poshtë do të quhet “Kontraktori menaxhues”,

të dyja bashkë do të quhen “Palët”,

ndërkohë që Punëdhënësi ka përzgjedhur Kontraktorin menaxhues si ofertuesin e preferuar në procesin e tenderimit të përgatitur dhe drejtuar nga organi shtetëror i autorizuar, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin për caktimin e Kontraktorit menaxhues, me qëllim kryerjen e shërbimeve të menaxhimit, sipas termave dhe kushteve të kësaj

Kontrate;

ndërkohë që Kontraktori menaxhues ka pranuar të sigurojë shërbimet, siç detajohen në propozimin e paraqitur nga vetë Kontraktori menaxhues,

është rënë dakord për si më poshtë:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Fjalët dhe shprehjet që përmbahen në këtë Kontratë do të kenë kuptimet e përcaktuara këtu më poshtë, përveç rastit kur përmbajtja e kërkon ndryshe:

“Kontratë” nënkupton këtë Kontratë menaxhimi.

“Ligji i zbatueshëm” nënkupton çdo akt shtetëror ose vendor të zbatueshëm, urdhëresë, dekret ose ligj tjetër, rregullore, akte nënligjore ose çdo kod apo udhëzues, licencë, miratim, leje, autorizim apo çdo aprovim tjetër, duke përfshirë kushtet e bashkëngjitura këtu (nëse kanë lidhje me sektorin e furnizimit me ujë ose jo), të Republikës së Shqipërisë ose të një pjese të saj, ose të çdo personi juridik shtetëror ose privat, të pavarur ose jo, me kompetencat përkatëse.

“Pagesa bazë” nënkupton çmimin total, i cili është paraqitur fillimisht në kuotimin e çmimit të Kontraktorit menaxhues.

“Data e fillimit” nënkupton datën që pason menjëherë ditën e fundit të periudhës së tranzicionit, datë në të cilën Kontraktori menaxhues merr përgjegjësi të plotë për administrimin e UK Kavajë sh.a.

“Data e hyrjes në fuqi” nënkupton datën që bie 31 (tridhjetë e një) ditë mbas datës kur Marrëveshja e financimit, e përmendur në paragrafin 22.1, ka hyrë në fuqi, pasi është miratuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë.

“Euro (€)” nënkupton monedhën e ligjshme, të vlefshme ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Monetar Europian.

“Pajisje” nënkupton të gjitha impiantet, rrjetet, ndërtesat dhe instalimet, që përdoren për furnizimin me ujë dhe kanalizimet dhe që i përkasin UK Kavajë, sh.a.

“Forcë madhore” nënkupton çdo ngjarje, si luftë, zjarr, grevë ose lëvizje sindikaliste, si dhe rrethana të tjera të karakterit të pazakonshëm, të ngjashme me to dhe me pasoja në rreth të gjerë dhe për një kohë të gjatë, si të shkaktuara nga fuqi të mbinatyrshme, shkaqe natyrore, veprimtari njerëzore ose politike, duke përfshirë këtu dhe aktet ose vendimet e çdo subjekti qeveritar ose joqeveritar, pa kufizime, e Bankës së Shqipërisë, ndryshime në ligje si brenda dhe jashtë juridiksionit të Punëdhënësit ose çdo ngjarje tjetër e ngjashme ose e ndryshme me të sipërpërmendurat, me kusht që një ngjarje e tillë është përtej kontrollit të Punëdhënësit dhe Kontraktorit menaxhues.

“Personeli bazë” nënkupton personelin që punësohet vetëm nga Kontraktori menaxhues, i përfshirë në propozimin e paraqitur nga Kontraktori menaxhues, i cili shërben si bazë për këtë Kontratë menaxhimi.

“KfW”-ja (Kreditanstalt für Wiederaufbau), nënkupton Bankën Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim, agjencia që është ngarkuar me menaxhimin e fondeve të bashkëpunimit financiar gjerman, të cilat do të financojnë projektin sipas kësaj Kontrate menaxhimi;

“Këshilli menaxhues” nënkupton këshillin menaxhues, anëtarët e të cilit do të caktohen nga Kontraktori menaxhues dhe miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës. Këshilli menaxhues do të marrë funksionet e tij në datën e fillimit dhe do të konsistojë në 3 (tre) persona, 2 (dy) prej të cilëve janë nga personeli bazë i Kontraktorit menaxhues dhe 1 (një) është punonjës i UK Kavajë, sh.a.

“Periudha e menaxhimit” nënkupton një periudhë kohore që fillon me datën e fillimit dhe përfundon në datën e zgjidhjes së kontratës.

“Pagesë ” nënkupton çdo pagesë që do të bëhet nga Punëdhënësi për Kontraktorin menaxhues, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate, pas përmbushjes nga Kontraktori menaxhues të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, detajet e të cilave përmbahen në nenin 7 dhe shtojcat B dhe C.

“Kriteret e përmbushjes” nënkuptojnë kriteret e përmbushjes të përcaktuara nga Punëdhënësi, siç përshkruhen në shtojcën C.

“Organi shtetëror i autorizuar” është organi i autorizuar nga ligjet në Republikën e Shqipërisë për të realizuar dhe monitoruar zbatimin e kësaj Kontrate.

“Pagesa e suksesit” nënkupton një pagesë, e cila do t’i paguhet Kontraktorit menaxhues bazuar në suksesin e punës së tij dhe të vlerësuar sipas kriterëve të përmbushjes.

“Këshilli mbikëqyrës” nënkupton Këshillin Mbikëqyrës të UK Kavajë, sh.a., siç përcaktohet në statutin e shoqërisë UK Kavajë, sh.a.

“Data e zgjidhjes të kontratës” është data që korresponдон me përvjetorin e 4t të datës së hyrjes së fuqi.

“Njoftimi i zgjidhjes” nënkupton njoftimin e zgjidhjes që mund të bëhet nga secila Palë, siç përshkruhet në nenin 11 të kësaj Kontrate.

“Axhenda e stafit dhe plani kohor” nënkupton dokumentacionin e personelit të Kontraktorit menaxhues dhe përdorimin e tij për shërbimet e menaxhimit, siç përmbahen në shtojcën F.

“Periudha e tranzicionit” nënkupton një periudhë prej 4 (katër) muajsh, ku muaji i parë është periudhë mobilizimi. Periudha e tranzicionit fillon në ditën që pason datën kur, pas miratimit në Parlament, hyn në fuqi Marrëveshja e financimit e përmendur në paragrafin 22.1.

“Klient i ujit” nënkupton çdo person privat, institucion publik, shoqëri apo çdo entitet tjetër, i cili merr ujë nga, apo shkarkon ujë të përdorur në infrastrukturën e Punëdhënësit.

“Ditë pune” nënkupton çdo ditë të javës, nga e hëna deri të premten, e cila nuk është festë kombëtare në Republikën e Shqipërisë.

1.2 Fjalët e përdorura vetëm në njëjës, përfshijnë edhe shumësin dhe referimi ndaj një gjinie, përfshin të gjitha gjinitë.

1.3 Titujt në këtë Kontratë përdoren vetëm për lehtësi dhe në rast interpretimi mund të mos merren parasysh.

1.4 Çdo referencë në këtë Kontratë lidhur me fjalë të shkruara, përfshin edhe ato të komunikuar elektronikisht ose me faks, ose mjete të tjera komunikimi të ngjashme me to.

1.5 Referenca e paragrafëve dhe shtojcave në këtë Kontratë nënkupton paragrafët dhe shtojcat në këtë Kontratë.

2. QËLLIMI

2.1 Parathënie

Në kuadrin e bashkëpunimit financiar shqiptaro-gjerman, infrastruktura e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në qytetin e Kavajës dhe fshatrave përreth po mbështetet, duke u përmirësuar nëpërmjet investimeve. Kjo mbështetje duhet të plotësohet dhe me shërbime menaxhuese nga jashtë, të cilat do të kryhen për një periudhë katërvjeçare, në bashkëpunim me personelin kryesor të Përfituesit. Kjo Kontratë përbën bazën ligjore për sigurimin e këtyre shërbimeve të menaxhimit, ku fondet për pagesën bazë dhe pagesën e suksesit do të sigurohen nëpërmjet KfW-së.

2.2 Kjo Kontratë do të zbatohet nga Kontraktori menaxhues dhe nga Punëdhënësi, dhe do të monitorohet nga organi shtetëror i autorizuar dhe nga Këshilli Mbikëqyrës.

2.3 Objektivat:

a) Punëdhënësi kërkon të sigurojë shërbime profesionale nga Kontraktori menaxhues për drejtimin komercial dhe teknik të Përfituesit.

b) Kontraktori menaxhues siguron menaxhim komercial dhe teknik të sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, siç përshkruhet në detaje në shtojcën D.

c) Të dyja Palët në këtë Kontratë kanë pranuar dhe respektojnë statutin e shoqërisë së UK Kavajë, sh.a., siç përmbahen nën shtojcën A, dhe siç mund të ndryshojnë.

d) Të dyja Palët në këtë Kontratë do të veprojnë në përputhje me ligjet e zbatueshme, në lidhje me detyrat e përfshira në këtë Kontratë menaxhimi dhe ato deklarojnë se do të veprojnë, dhe vendosin vetëm në të mirë të rezultatit optimal të Përfituesit dhe shërbimit më të mirë të mundshëm të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonën e shërbimit të Përfituesit.

3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E PALËVE

3.1 Punëdhënësi dhe Përfituesi:

a) do të mbështesin Kontraktorin menaxhues me të gjithë autoritetin e tyre;

b) do të lejojnë Kontraktorin menaxhues të marrë të gjitha vendimet brenda përgjegjësisë së tij, siç përshkruhen në detaje në planin e menaxhimit të bashkëngjitur kësaj Kontrate, si shtojca E, duke përfshirë gjithashtu edhe përgjegjësitë lidhur me fondet e investimit që i jepen UK Kavajë, sh.a.;

c) do të miratojnë ose mosmiratojnë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës vetëm për arsye ligjërsh të vlefshme dhe pa vonesë të paarsyeshme;

d) do të miratojnë ose mosmiratojnë vendimet e Këshillit Mbikëqyrës vetëm për arsye ligjërsh të vlefshme dhe pa vonesë të paarsyeshme;

e) do t'i dorëzojë Kontraktorit menaxhues kopje të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm që kërkohet nga Kontraktori menaxhues dhe të sigurojë akses në të gjitha asetet teknike, impiantet,

ndërtesat, programet kompjuterike dhe informacionin e padokumentuar;

f) do të bëjë, pa vonesë, ndryshimet e duhura në statutin e shoqërisë UK Kavajë, sh.a., duke pasqyruar dispozitat dhe kushtet e kësaj Kontrate.

3.2 Kontraktori menaxhues:

a) do të ketë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë siç përcaktohen në shtojcën D dhe në shtojcën G bashkëngjitur kësaj Kontrate;

b) përveç detyrave dhe përgjegjësiave të përmendura në paragrafin paraardhës, do të marrë përsipër formimin e këshillit menaxhues dhe do ta caktojë këtë këshill menaxhues të marrë përsipër fuqi të plota të përfaqësimit ligjor të UK Kavajë, sh.a.;

c) do të zbatojë vendimet e marra nga këshilli menaxhues mbi bazën e shumicës së thjeshtë;

d) do të zbatojë procedurat e zbatueshme të prokurimit, të shoqëruara me ekzekutimin e kredive ose granteve të akorduara UK Kavajë, sh.a.

4. ZËVENDËSIMI I STAFIT TË PËRFITUESIT DHE PERSONELIT BAZË TË KONTRAKTORIT MENAXHUES

4.1 Stafi i Përfituesit mund të zëvendësohet nga këshilli menaxhues dhe ndryshimi(et) respektiv(e) do t'i dërgohen si kopje, Këshillit Mbikëqyrës dhe KfW-së.

4.2 Zëvendësimi i një anëtarit të këshillit menaxhues do të bëhet nga Këshilli Mbikëqyrës, me propozimin e Kontraktorit menaxhues dhe vendimi i Këshillit Mbikëqyrës për zëvendësimin në fjalë do t'i dërgohet Kontraktorit menaxhues dhe KfW-së.

4.3 Kontraktori menaxhues mund të propozojë zëvendësimin e personelit bazë të tij duke lajmëruar me shkrim 1 (një) muaj më përpara Këshillin Mbikëqyrës dhe KfW-në. Këshilli Mbikëqyrës ose KfW-ja mund të refuzojnë një zëvendësim të tillë për arsye të mira, por sidoqoftë një përgjigje duhet kthyer brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendrike pas marrjes së lajmërimit, përndryshe Kontraktori menaxhues ka të drejtë të bëjë zëvendësimin.

5. INFORMIMI DHE RAPORTIMI

5.1 Palët do të informojnë njëra-tjetrën lidhur me çfarëdo ndryshimi në personel, planin kohor dhe programin e punës, siç përcaktohen në shtojcat F dhe G, bashkëngjitur kësaj Kontrate.

5.2 Kontraktori menaxhues do të hartojë dhe dorëzojë raporte tremujore në Këshillin Mbikëqyrës, të shoqëruara me një kopje për organin shtetëror të autorizuar, ku përshkruhet veprimtaria e tij dhe do të dokumentohet arritja e objektivave të punës, bashkëngjitur me faturën tremujore, siç përcaktohet në paragrafin 2.7 të shtojcës D. Për më tepër, Kontraktori menaxhues duhet t'u japë Këshillit Mbikëqyrës, organit shtetëror të autorizuar dhe KfW-së çdo informacion lidhur me këtë Kontratë, sipas kërkesës që mund të bëhet herë pas here nga secili prej tyre.

5.3 Kontraktori menaxhues është i detyruar të vëzhgojë të gjitha veprimtaritë e këshillit menaxhues dhe të sigurojë se praktikat teknike dhe menaxhuese janë në përputhje me praktikat e njohura në sektorin e ujit. Kontraktori menaxhues duhet të informojë organin shtetëror të autorizuar dhe Këshillin Mbikëqyrës për çdo rrethanë që mund të ndikojë në suksesin e punës së Përfituesit.

5.4 Punëdhënësi do t'i japë pa vonesë njoftim Kontraktorit menaxhues mbi çdo ndryshim mbi gjendjen e pronësisë së UK Kavajë, sh.a. dhe çdo ndryshim në anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

5.5 Raportet tremujore dhe vjetore do të përmbajnë një hyrje përmbledhëse në gjuhët anglisht dhe shqip.

6. PAGESA, MËNYRA E PAGESËS

6.1 Duke marrë në konsideratë përmbushjen e detyrimeve nga ana e Kontraktorit menaxhues, sipas kësaj Kontrate, Punëdhënësi do ta paguajë Kontraktorin menaxhues duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 7.

6.2 Pagesa paradhënie do të bëhet brenda 21 (njëzet e një) ditëve nga data e hyrjes në fuqi, pas marrjes së një fature nga Punëdhënësi, të shoqëruar me një garanci të pagesës paradhënie me vlefshmëri 18 (tetëmbëdhjetë) muaj. Një model i garancisë së pagesës paradhënie është bashkëngjitur kësaj Kontrate si shtojca I. Pagesa paradhënie do t'i rikthehet Punëdhënësit nga Kontraktori menaxhues në një seri pagesash të barabarta që kreditohen nga secila prej gjashtë pagesave të para tremujore që i takojnë Kontraktorit menaxhues. Pas rikthimit të plotë nga ana e Kontraktorit menaxhues të pagesës paradhënie, Punëdhënësi do t'i dorëzojë pa vonesë Kontraktorit menaxhues origjinalin e garancisë së pagesës paradhënie.

6.3 Në rast se Punëdhënësi mungon të paguajë Kontraktorin menaxhues në afatin e duhur siç përcaktohet në paragrafin 6.2 apo mungon të kryejë çfarëdo pagesë tjetër në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate, Kontraktori menaxhues ka të drejtë të kërkojë menjëherë pagimin e shumës që i takon së bashku me interesin përkatës. Norma e interesit që aplikohet do të jetë e së njëjtës monedhë si pagesa dhe për një periudhë kohe të barabartë me periudhën nga data kur duhej të ishte kryer pagesa deri në datën kur ajo kryhet në favor të Kontraktorit menaxhues. Norma e interesit në euro që do të përdoret është 3 muaj-EURIBOR + 4%.

6.4 Shpërblimi për Kontraktorin menaxhues do të paguhet në euro dhe do të kryhet nëpërmjet transferave bankare elektronike, sipas procedurave të disbursimit të KfW-së, si vijon:

To: AQUAMUNDO GmbH

Bank Name: Dresdner Bank AG
Bank Address: P2, 12
68008 Mannheim, Federal Republic of Germany
Account Number: 668 108 600
Swift Code: DRES DE FF 670
BLZ: 670 800 50

7. TERMAT E PAGESËS

7.1 Pagesa e pagesës bazë, në shumën 713 820 (shtatëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet) euro, do të kryhet si vijon:

a) Pagesa bazë:

Pagesa paradhënie: 20 % (njëzet për qind) brenda 21 (njëzet e një) ditëve nga data e hyrjes në fuqi së kësaj Kontrate dhe mbi bazën e paraqitjes së një garancie për pagesën paradhënie me vlefshmëri 18 (tetëmbëdhjetë) muaj.

Pagesat tremujore: 13 % (trembëdhjetë për qind) për 6 (gjashtë) pagesa tremujore, të pasuara nga 2% (dy për qind) për 9 (nëntë) pagesa tremujore, të pasuara nga 4% (katër për qind) për 1 (një) pagesë tremujore, ku secila prej tyre do të paguhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data që Kontraktori menaxhues dorëzon raportet tremujore dhe faturat.

b) Pagesa e suksesit:

Shuma e pagesës së suksesit llogaritet në bazë të kriterëve të përmbushjes të përcaktuara në shtojcën C. Rezultati i arritur do të vlerësohet në bazë të raportit vjetor që dorëzon Kontraktori menaxhues brenda 21 (njëzet e një) ditëve që pasojnë përvjetorin e çdo date të fillimit. Kërkesa për pagimin e pagesës vjetore të suksesit do të bëhet nëpërmjet paraqitjes së një fature nga ana e Kontraktorit menaxhues, të shoqëruar me raportin vjetor të përmendur më lart.

7.2 Shuma e pagesës së suksesit do të paguhet brenda 40 (dyzet) ditëve nga dorëzimi i faturës. Pagimi i pagesës së suksesit nga ana e Punëdhënësit nënkupton pranimin e rezultateve të arritura nga Kontraktori menaxhues në vitin pararendës.

7.3 Në rast të zgjidhjes së parakohshme sipas nenit 11, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas datës së zgjidhjes, Kontraktori menaxhues do të dorëzojë një faturë për pagesat e mbetura deri në datën e zgjidhjes, e cila përcaktohet në njoftimin e zgjidhjes. Punëdhënësi do ta paguajë atë faturë brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga marrja në dorëzim e faturës.

7.4 Në rast se Kontraktori menaxhues nuk është i aftë të mbajë një nivel të caktuar të rezultatit për një objektiv pune të përcaktuar, për të cilin është kryer një pagesë e suksesit në një vit pararendës, atëherë pagesa e suksesit do të rillogaritet për atë objektiv pune në vitin pasardhës, në bazë të rezultatit aktual dhe Kontraktori menaxhues do të kreditojë Punëdhënësin. Krediti për objektivin specifik të punës do të jetë i barabartë me diferencën ndërmjet shumës së pagesës së mëparshme të suksesit për atë objektiv specifik, me shumën e llogaritur të pagesës aktuale të suksesit për të njëjtin objektiv. Në rast se shuma totale e pagesës së suksesit për të gjitha objektivat e punës për një vit të dhënë është më e vogël se ajo e vitit paraardhës, atëherë krediti që shkon në favor të Punëdhënësit do të zbritet nga pagesa (t) tremujore të pagesës bazë. Metodologjia e llogaritjes së pagesave të suksesit do të bëhet siç përcaktohet në shtojcën C – Kriteret e përmbushjes.

7.5 Përveç pagesave të lidhura me pagesat bazë dhe të suksesit dhe/ose shpërblime shtesë, që i detyrohet Kontraktorit menaxhues, Punëdhënësi do të kompensojë Kontraktorin menaxhues për të

gjithë zërat e blerë, të cilët do t'i transferohen Punëdhënësit, sipas kushteve të zgjidhjes së parakohshme apo zgjidhjes si pasojë e forcës madhore. Zërat që do të transferohen do të jenë të gjitha pajisjet kompjuterike dhe programet (hardware dhe software), pajisjet e zyrave, mobiljet e zyrave dhe gjeneratori diesel. Vlera origjinale e këtyre zërave do të jetë ajo e përcaktuar në fatura të rregullta dhe e dokumentuar në raportet tremujore. Kufiri i sipërm për vlerat e këtyre zërave është i barabartë me shumën e çmimeve të tyre respektive të treguara në shtojcën B - Ndarja e çmimit total dhe treguesit e ndryshimit të ekonomisë, nën "Ndarja e shpenzimeve të tjera direkte të projektit", që përmbahen në propozimin financiar të Kontraktorit menaxhues dhe kjo shumë është e barabartë me 141 185.00 (njëqind e dyzet e një mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) euro. Shuma që do t'i paguhet Kontraktorit menaxhues nga Punëdhënësi për këta zëra do të përcaktohet nga llogaritja e amortizimit sipas metodës lineare, për një periudhë 2 (dy)-vjeçare, të shumës totale të shpenzimeve të dokumentuara që paraqiten në raportet tremujore. Në kontekstin e këtij paragrafi, pas 2 (dy) viteve të para të Kontratës, Punëdhënësi nuk i detyrohet asnjë shumë Kontraktorit menaxhues.

7.6 Të gjitha pajisjet e tjera, me përjashtim të zërave të specifikuar në paragrafin paraardhës, do të mbeten pronë e Kontraktorit menaxhues, në rast të zgjidhjes së parakohshme ose të zgjidhjes si pasojë e forcës madhore.

8. PAJISJET DHE NEVOJAT PËR MATERIALE

8.1 Kontraktori menaxhues do të kryejë procedurat e prokurimit për operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve brenda kufirit të buxhetit vjetor për kategorinë e shpenzimit të kryer. Të gjitha këto shpenzime do të paraqiten të detajuara nga Kontraktori menaxhues në raportet tremujore që ai i dërgon Këshillit Mbikëqyrës.

8.1.1 Të gjitha blerjet me një vlerë mbi 5 000 (pesë mijë) euro kërkojnë miratimin e Këshillit Mbikëqyrës.

8.1.2 Kërkesat për blerje të tilla do të miratohen ose mosmiratohen me shkrim, nga Këshilli Mbikëqyrës brenda 5 (pesë) ditëve të punës nga data e dorëzimit të kërkesës nga Kontraktori menaxhues në Këshillin Mbikëqyrës.

8.2 Pajisjet dhe pjesët e këmbimit do të blihen në sasi të arsyeshme, do të jenë të llojeve dhe përmasave të duhura dhe në përputhje me specifikimet për pajisjet. Në rast zëvendësimi (të pjesëve) Kontraktori menaxhues do të sigurohet që skicat e pjesëve dhe/ose manualët e prodhuesit, sipas nevojës, do të sigurohen nga furnizuesit.

8.3 Në rast se Këshilli Mbikëqyrës nuk kthen përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve të punës, sipas paragrafit 8.1, Kontraktori menaxhues ka të drejtë të kryejë prokurimet që janë brenda përgjegjësisë së tij, në përputhje me buxhetet e miratuara vjetore të UK Kavajë, sh.a. dhe rregullat e prokurimit të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, dhe do të rimbursohet nga Punëdhënësi për shpenzimet respektive brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dorëzimi i një fature nga Kontraktori menaxhues tek Këshilli Mbikëqyrës. Punëdhënësi heq dorë nga e drejta e ngritjes së ndonjë padie apo kundërshtie të një kërkesë të tillë për rimbursim nga ana e Kontraktorit menaxhues, me kusht që Kontraktori menaxhues të ketë ndjekur procedurën e parashtruar në paragrafin 8.1.

8.4 Në emër të Punëdhënësit, Kontraktori menaxhues do të marrë, kur është e nevojshme, të gjitha miratimet për llojin e pajisjeve, në përputhje me rregullat në fuqi, lidhur me llojet e pajisjeve për të cilat kërkohet miratim.

9. SHPENZIMET SHITESË

9.1 Në rast se në çdo kohë gjatë periudhës së menaxhimit, Kontraktori menaxhues ka një rritje në shpenzimet e menaxhimit apo në shpenzimet e tjera, pavarësisht se në cilën monedhë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në kostot e ndonjë pune që kërkohet nga Kontraktori menaxhues për arritjen e kritereve të përmbushjes, si rezultat i:

9.1.1 mospagesës nga Punëdhënësi;

një ngjarje të forcës madhore siç përcaktohet më poshtë;

një ndryshimi në ligjin e zbatueshëm pas datës së hyrjes në fuqi; dhe Kontraktori menaxhues është i aftë të tregojë në mënyrë bindëse se si çdonjëra nga ngjarjet e parashtruara më lart:

i) ka shkaktuar një rritje apo ndryshim domethënës në gamën e tij të punës;

ii) ka shkaktuar ndonjë kosto shtesë që nuk mund të parashikohej se do të ndodhte gjatë kryerjes së detyrës, atëherë, Punëdhënësi, pa hequr dorë nga të drejtat e tjera të tij sipas kësaj Kontrate, do t'i paguajë Kontraktorit menaxhues, shumat siç paraqiten në paragrafin 9.2.

9.2 Në rast se zbatohet paragrafi 9.1, Punëdhënësi do të kryejë në favor të Kontraktorit

menaxhues një pagesë të rritur, për të cilën bihet dakord nga të dyja Palët dhe e cila do të pasqyrojë:

i) kostot shtesë të shkaktuara gjatë periudhës në të cilën mbizotëruan rrethanat e ngjarjes në fjalë; plus

ii) çdo shumë tjetër që mund t'i paguhet Kontraktorit menaxhues për mbulimin e kostove të tij; plus

iii) interesin mbi shumat e përmendura në paragrafin (i) dhe në normën e interesit të përcaktuar sipas paragrafit 6.3, të llogaritur duke filluar nga data në të cilën u shkaktua rritja e kostove deri në datën e kryerjes së pagesës.

9.3 Kontraktori menaxhues do t'i dërgojë njoftim me shkrim Punëdhënësit, ku të tregojë në mënyrë të qartë shumat, të cilat Punëdhënësi i detyrohet Kontraktorit menaxhues sipas paragrafit 9.2, deri në datën e njoftimit. Kontraktori menaxhues ka të drejtë të kërkojë pagesat për shpenzime të tilla, menjëherë dhe pavarësisht nga intervalet e pagesave siç tregohen në paragrafin 7.1.

9.4 Të drejtat e Kontraktorit menaxhues sipas këtij neni nuk do të ndikojnë në ndonjë të drejtë tjetër, të cilën Kontraktori menaxhues mund ta ketë sipas kësaj Kontrate, duke përfshirë të drejtën e zgjidhjes së kësaj Kontrate.

9.5 Në rast se Punëdhënësi nuk bie dakord me rritjen e kostos sipas paragrafit 9.2, kjo mosmarrëveshje do t'i nënshtrohet vlerësimit të një revizori të pavarur që do të emërohet sipas paragrafëve 19.2 dhe 19.3.

10. PËRFUNDIMI I SHËRBIMEVE TË MENAXHIMIT

10.1 Në përfundim të periudhës së menaxhimit, Kontraktori menaxhues do t'i dorëzojë Punëdhënësit të gjithë dokumentacionin, si dhe zërat e blerë dhe të rimbursuar nën shpenzimet direkte të projektit.

10.2 Kontraktori menaxhues do të dorëzojë raportin vjetor përfundimtar brenda 21 (njëzet e një) ditëve që pasojnë datën e përfundimit të periudhës së menaxhimit.

10.3 Jo më vonë se 1 (një) muaj nga data e dorëzimit të raportit vjetor përfundimtar, Punëdhënësi do t'i dorëzojë Kontraktorit menaxhues një vërtetim përfundimtar, me kusht që Punëdhënësi të mos paraqesë objeksione materiale të raportit final. Vërtetimi i përfundimit do t'i dërgohet Kontraktorit menaxhues menjëherë sapo të tërhiqen objeksionet materiale të sipërpërmendura.

10.4 Të gjitha detyrimet e raportimit nga Kontraktori menaxhues dhe detyrimet e pagesës nga Punëdhënësi do të përbushen, pavarësisht nga përfundimi i shërbimeve të menaxhimit.

11. ZGJIDHJA E PARAKOHSHME

11.1 Në rast se kjo Kontratë zgjidhet pas një njoftimi për zgjidhje të lëshuar nga Punëdhënësi dhe e cila nuk vjen si pasojë e ndonjë mospërbushjeje detyrimesh nga ana e Kontraktorit menaxhues, Kontraktori menaxhues ka të drejtën të paguhet për të gjithë pagesën bazë deri në datën e zgjidhjes, plus një shumë të llogaritur për të gjithë pagesën bazë deri në datën e zgjidhjes, të barabartë me skonton e shprehur në përqindje, siç tregohet në llogaritjen e çmimit të Kontraktorit menaxhues, në shtojcën B. Paga e pagesës bazë do të llogaritet në bazë proporcionale, duke filluar nga data e zgjidhjes të përcaktuar në njoftimin e zgjidhjes.

11.2 Në rast se kjo Kontratë zgjidhet pas një njoftimi për zgjidhje të lëshuar nga Punëdhënësi dhe e cila nuk vjen si pasojë e ndonjë mospërbushjeje detyrimesh nga ana e Kontraktorit menaxhues, Kontraktori menaxhues ka të drejtën të paguhet për pagesën e suksesit sipas shtojcës C, duke marrë për bazë datën e zgjidhjes të përcaktuar në njoftimin e zgjidhjes.

11.3 Në rast se kjo Kontratë zgjidhet pas një njoftimi për zgjidhje të lëshuar nga Punëdhënësi dhe e cila nuk vjen si pasojë e ndonjë mospërbushjeje detyrimesh nga ana e Kontraktorit menaxhues, Kontraktori menaxhues ka të drejtën e pagesës shtesë, përveç asaj që Punëdhënësi duhet t'ia paguajë sipas dispozitave të kësaj Kontrate, në shumat që vijojnë dhe duke u bazuar në datën e zgjidhjes të përcaktuar në njoftimin e zgjidhjes.

Data e zgjidhjes gjatë	Shuma e pagesës shtesë
Vitit të parë të Kontratës	100 000 euro
Vitit të dytë të Kontratës	75 000 euro
Vitit të tretë të Kontratës	50 000 euro
Vitit të katërt të Kontratës	25 000 euro

11.4 Në rast se Kontraktori menaxhues deklarohet i falimentuar në çdo kohë, atëherë kjo Kontratë do të konsiderohet e zgjidhur në mënyrë të menjëhershme.

11.5 Në rast se Punëdhënësi nuk përmbush detyrimet e tij financiare sipas kësaj Kontrate, Kontraktori menaxhues do t'i dërgojë menjëherë Punëdhënësit njoftim me shkrim, nëpërmjet të cilit i kërkon atij të plotësojë detyrimet në fjalë. Në rast se detyrimi nuk përmbushet brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike, pasi Punëdhënësi ka marrë njoftimin, Kontraktori menaxhues ka të drejtën, pa hequr dorë nga të drejtat e tjera të tij sipas kësaj Kontrate, të zgjidhë Kontratën 14 (katërmëdhjetë) ditë, pasi t'i ketë dërguar Punëdhënësit një njoftim me shkrim për zgjidhje.

11.6 Në rast se Punëdhënësi nuk përmbush ndonjë prej detyrimeve materiale sipas kësaj Kontrate, që janë të ndryshme nga detyrimet financiare dhe të cilat për një periudhë kohe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike të njëpasnjëshme, ndikojnë materialisht në aftësinë e Kontraktorit menaxhues për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate, Kontraktori menaxhues ka të drejtën, pa hequr dorë nga të drejtat e tjera të tij sipas kësaj Kontrate, të zgjidhë Kontratën 14 (katërmëdhjetë) ditë, pasi t'i ketë dërguar Punëdhënësit një njoftim me shkrim për zgjidhje.

11.7 Në rast se Kontraktori menaxhues nuk përmbush ndonjë prej detyrimeve materiale sipas kësaj Kontrate, Punëdhënësi do t'i dërgojë Kontraktorit menaxhues njoftim brenda 24 orëve nga momenti i vërtetimit të mospërmbushjes së detyrimit dhe Kontraktori menaxhues ka të drejtë të korrigjojë mosplotësimin brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike dhe kjo periudhë mund të zgjatet me marrëveshje të dyanshme. Dështimi i Kontraktorit menaxhues në korrigjimin e sipërpërmendur lejon Punëdhënësin të zgjidhë Kontratën. Zgjidhja e Kontratës e çliron Punëdhënësin nga çdo detyrim tjetër të tij, përveç detyrimeve financiare për kryerjen e pagesave dhe kompensimeve të tjera që i takojnë Kontraktorit menaxhues deri në datën e zgjidhjes, siç përcaktohet në paragrafin 11.8.

11.8 Në të gjitha rastet e zgjidhjes të sipërpërmendura, pronësia e të gjitha dokumenteve dhe pajisjeve, të cilat janë blerë ose krijuar nga Kontraktori menaxhues dhe të cilat janë të lidhura me shërbimet e menaxhimit, do t'i kalohen Punëdhënësit menjëherë dhe Punëdhënësi do të kompensojë financiarisht Kontraktorin menaxhues ose likuiduesit e Kontraktorit menaxhues në rastin e falimentimit, në një masë që do të vendoset sipas dispozitave të paragrafit 7.5.

11.9 Njoftimi për zgjidhje i dërguar në përputhje me këtë nen është i vlefshëm vetëm nëse kryhet në përputhje me nenin 25.

11.10 Në të gjitha rastet e zgjidhjes së parakohshme, Punëdhënësi ka të drejtë të tërheqë nga garancia e pagesës paradhënie atë shumë, e cila nuk është paguar nga Kontraktori menaxhues në përputhje me paragrafin 6.2.

12. FORCA MADHORE

12.1 Kur ndodh një ngjarje e forcës madhore, Kontraktori menaxhues nuk do të ketë detyrime kundrejt Punëdhënësit për të përmbushur shërbimet e menaxhimit të kërkuara nga kjo Kontratë, të cilat ngjarja e forcës madhore nuk lejon të përmbushen.

12.2 Secila nga Palët do të njoftojë Palën tjetër mbi ndodhjen e një ngjarjeje të forcës madhore dhe të detyrimit(e) kontraktual(e) që nuk mund të përmbushë për shkak të ngjarjes së forcës madhore, nëpërmjet një njoftimi me shkrim të dërguar brenda 5 (pesë) ditëve të punës nga ndodhja e ngjarjes së forcës madhore. Pala tjetër duhet të konfirmojë me shkrim pranimin e një ngjarjeje të tillë të forcës madhore, brenda 5 (pesë) ditëve të punës. Pala që deklaron një ngjarje të forcës madhore do të njoftojë Palën tjetër pa vonesë për mbarimin e një ngjarjeje të tillë.

12.3 Në rastin e ndodhjes së një ngjarjeje të forcës madhore, periudha e menaxhimit do të zgjatet me një interval kohe të barabartë me periudhën gjatë së cilës shërbimet e menaxhimit ishin të ndërprera. Kontraktori menaxhues ka të drejtën të paguhet në përputhje me dispozitat e shtojcës B, për periudhën gjatë së cilës zgjat forca madhore.

12.4 Në rast se një ngjarje e forcës madhore zgjat për më shumë se 3 (tre) muaj, Kontraktori menaxhues ka të drejtën të paguhet në përputhje me dispozitat e shtojcës B, për atë periudhë 3 (tre) muajore pas së cilës Kontrata do të zgjidhet. Pas datës së zgjidhjes, Kontraktori menaxhues nuk ka përgjegjësi për shërbimet e pakryera dhe Punëdhënësi nuk ka detyrim të paguajë ndonjë kompensim, pagesë të lidhur me zgjidhjen e parakohshme apo pagesë suksesi. Megjithatë, Palët do të zhvillojnë një takim jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së zgjidhjes së Kontratës të përcaktuar sipas këtij paragrafi, për të diskutuar mbi interesin e dyanshëm në zgjatjen e periudhës së forcës madhore dhe rishikimit të dispozitave dhe kushteve të Kontratës. Zgjatja e periudhës së forcës madhore mund

të vendoset vetëm me marrëveshje ndërmjet dy Palëve.

13. SIGURIMI, KUJDESI DHE SHËNDETI

Kontraktori menaxhues do të bëjë një përpjekje për të siguruar që veprimet që lidhen me menaxhimin, operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve kryhen në mënyrë të tillë që të sigurojë maksimumin e kujdesit ndaj të gjithë të punësuarve të Përfituesit dhe të Kontraktorit menaxhues, dhe ndaj të gjitha palëve që mund të preken ose përfshihen nga veprimtaria e Kontraktorit menaxhues. Kontraktori menaxhues duhet të zbatojë të gjitha rregullat dhe ligjet që lidhen me kujdesin ndaj zjarrit, shëndetit dhe sigurisë, ashtu siç kërkohet në Republikën e Shqipërisë.

14. GARANCITË E PUNËDHËNËSIT

14.1 Punëdhënësi i paraqet Kontraktorit menaxhues garancitë e mëposhtme:

14.1.1. kjo Kontratë lidhet në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

14.1.2 Përfituesi është një shoqëri anonime e themeluar në bazë të statutit bashkëngjitur shtojcës A;

14.1.3 Punëdhënësi ka kompetenca të plota të realizojë këtë Kontratë;

14.1.4 Punëdhënësi ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të realizuar këtë Kontratë në përputhje me ligjin dhe për të përmbushur detyrimet e veta sipas kësaj Kontrate;

14.1.5 Punëdhënësi ia ka deleguar përgjegjësitë e monitorimit të Kontratës Këshillit Mbikëqyrës të UK Kavajë, sh.a. dhe një delegim i tillë nuk do të interpretohet si heqje dorë apo braktisje e përgjegjësi që ka Punëdhënësi lidhur me monitorimin e Kontratës;

14.1.6 kjo Kontratë është e zbatueshme së bashku me kushtet e saj në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë, në datën e hyrjes në fuqi, pa qenë nevoja e ndërmarrjes së ndonjë veprimi të mëtejshëm nga ndonjëra nga Palët;

14.1.7 shoqëria lokale ligjore që do të ngrihet sipas paragrafit 15.2 më poshtë do të konsiderohet si pjesë e pandashme e organizimit të Kontraktorit menaxhues për përmbushjen e detyrimeve të tij që rrjedhin nga kjo Kontratë menaxhimi.

14.2 Kjo Kontratë nuk do të ndikohet nga ndonjë ndryshim në gjendjen e pronësisë së UK Kavajë, sh.a.

15. GARANCITË E KONTRAKTORIT MENAXHUES

15.1 Kontraktori menaxhues i paraqet Punëdhënësit garancitë e mëposhtme:

15.1.1 është shoqëri e themeluar në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën Federale Gjermane, siç është regjistruar në regjistrin tregtar, në numrin e regjistrimit HRB 8601 në Mannheim, Republika Federale Gjermane;

15.1.2 përfaqësuesi i Kontraktorit menaxhues është fuqiplotë për të lidhur këtë Kontratë dhe

15.1.3 ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të realizuar këtë Kontratë në përputhje me ligjin dhe për të përmbushur detyrimet e veta sipas kësaj Kontrate.

15.2 Kontraktori menaxhues merr përsipër të ngrejë një shoqëri lokale ligjore në Republikën e Shqipërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi. Kjo shoqëri lokale do të mbështesë Kontraktorin menaxhues në sigurimin e shërbimeve në Shqipëri, ekskluzivisht për qëllimet që lidhen me këtë Kontratë.

16. DËMSPËRBLIMI DHE MARRËDHËNIET NDËRMJET PALËVE

16.1 Kontraktori menaxhues do të dëmshpërblejë Punëdhënësin për çdo padi të arsyeshme të ngritur kundër Punëdhënësit, si rezultat i dëmtimeve personale ose dëmtimeve të pronës, të shkaktuara nga neglizhenca e madhe e Kontraktorit menaxhues ose personelit të tij bazë.

16.2 Pavarësisht nga çfarëdo që përmbahet në këtë Kontratë dhe që thotë të kundërtën, Kontraktori menaxhues nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë dëm ose humbje të veçantë, jo të drejtpërdrejtë ose që vjen si pasojë, si për shembull, por pa u kufizuar në, humbjet në të ardhura, humbjet në përdorim, humbjet në prodhim, kosto kapitale ose kosto të lidhura me ndërprerjen e operimeve.

16.3 As Kontraktori menaxhues, as Punëdhënësi nuk do të kenë ndonjë përgjegjësi të çfarëdo lloji lidhur me detyrimet e marra përsipër sipas kësaj Kontrate nga Pala tjetër dhe as në lidhje me paditë e punës të personelit të secilës prej palëve dhe asgjë në këtë Kontratë nuk do të interpretohet sikur Kontraktori menaxhues dhe Punëdhënësi janë partnerë, agjentë apo përfaqësues lokalë të njëri-tjetrit, apo që kanë krijuar ndonjë marrëdhënie besimi ndërmjet tyre.

17. IMPORTIMI I MATERIALEVE DHE PAJISJEVE; TË DHËNA PËR TË PUNËSUARIT

17.1 Kontraktori menaxhues do të përgatisë të gjitha dokumentet e nevojshme për Punëdhënësin, në mënyrë që ai të përfitojë të gjitha autorizimet dhe lejet e nevojshme qeveritare nga autoritetet përkatëse shqiptare për importimin e materialeve dhe pajisjeve (përfshirë pa kufizime të gjithë aksesoret, pjesët e veçanta dhe çdo material tjetër), të cilat, sipas gjykimit të Kontraktorit menaxhues, janë të nevojshme për t'u importuar.

17.2 Kontraktori menaxhues do të mbajë përgjegjësi për të dhënat e punëmarrësve jorezidentë, të cilët konsiderohen të domosdoshëm për përmbushjen e detyrimeve nga Kontraktori menaxhues. Punëdhënësi do t'i japë ndihmën e nevojshme Kontraktorit menaxhues për marrjen, pa vonesë, të lejeve administrative të nevojshme sipas kësaj dispozite.

18. TAKIMI VJETOR

18.1 Një takim vjetor do të zhvillohet ndërmjet përfaqësuesve të Punëdhënësit dhe Kontraktorit menaxhues brenda dy javësh nga dorëzimi i raportit vjetor nga Kontraktori menaxhues. Raporti vjetor do të dorëzohet brenda 21 (njëzet e një) ditëve nga dita e përvjetorit të datës së hyrjes në fuqi, nga Kontraktori menaxhues.

18.2 Gjatë takimit vjetor do të diskutohen, por pa u kufizuar në to, çështjet e mëposhtme:

18.2.1 bashkëpunimi ndërmjet Palëve dhe linjat e komunikimit;

18.2.2 përmbushja e detyrimeve nga ana e Kontraktorit menaxhues në lidhje me ato të Punëdhënësit dhe pagesat që klientët e ujit i kanë bërë Punëdhënësit;

18.2.3 vlerësimi i arritjes së treguesve të suksesit si bazë për vlerësimin e pagesës vjetore që paguhet sipas nenit 7 dhe siç përcaktohet në shtojcën C të kësaj Kontrate;

18.2.4 çdo padi ose ankesë që ngrihet nga secila nga Palët;

18.2.5 sugjerime për ndryshime në objektivat e punës së Punëdhënësit, siç përshkruhen në shtojcën C;

18.2.6 sugjerime për ndryshime në kriteret e performancës që lidhen me pagesën e suksesit, siç përshkruhen në shtojcën C;

18.2.7 çdo ndryshim në ligjin e zbatueshëm që drejton këtë Kontratë;

18.2.8 ndryshimet në planifikimin lokal ose autorizimet qeveritare, të cilat mund të ndikojnë në shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

19. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

19.1 Të dyja Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrë miqësore çdo mosmarrëveshje, kundërshti ose padi të ngritur në lidhje me këtë Kontratë ose shkeljen, zgjidhjen ose pavlefshmërinë e Kontratës. Sipas kuptimit të këtij paragrafi, një mosmarrëveshje ekziston kur njëra nga Palët i dërgon Palës tjetër një njoftim me shkrim mbi natyrën e mosmarrëveshjes.

19.2 Të dyja Palët bien dakord që KfW-ja të emërojë një revizor të pavarur, i cili do të asistojë në vlerësimin e përmbushjes së detyrimeve, si dhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ky revizor do të përgatisë dhe paraqesë një raport vëzhgimi në takimin vjetor, bazuar në një shqyrtim në vend të gjendjes teknike dhe ekonomike të shërbimeve të furnizimit me ujë.

19.3 Me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin lidhur me vlerësimin e arritjes së objektivave të punës, Palët së pari do t'i drejtohen revizorit të pavarur të emëruar nga KfW-ja dhe për të cilin është rënë dakord nga Palët dhe, në rast se mosmarrëveshja mbetet e pazgjidhur, Palët do t'ia referojnë atë mosmarrëveshje një arbitri të vetëm që do të caktohet nga Dhoma Federale e Tregtisë së Austrisë, në Vienë (Bundeswirtschaftskammer).

19.4 Arbitrimi do të kryhet në përputhje me rregullat e arbitrit të UNCITRAL-it që janë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate. Vendi i arbitrazhit do të jetë në Tiranë, Shqipëri dhe gjuha që do të përdoret gjatë procesit të arbitrit do të jetë gjuha angleze.

20. NDRYSHIMI DHE RINEGOCIMI I KËSAJ KONTRATE

20.1 Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim ndërmjet Palëve.

20.2 Palët në këtë marrëveshje mundet që të rinegociojnë pjesë apo të gjithë Kontratën, në çdo kohë. Megjithatë, kërkesa e njëres prej Palëve për të rinegocuar nuk do të interpretohet si zgjidhje e kësaj Kontrate dhe Palët do të vazhdojnë të respektojnë të njëjtat dispozita dhe kushte të kësaj Kontrate në rast se njëra Palë nuk pranon një propozim për rinegocim të paraqitur nga Pala tjetër.

20.3 Kur identifikohet një arsye për rinegocim qoftë nga Punëdhënësi, qoftë nga Kontraktori menaxhues, do të thirret një mbledhje në të cilën do të diskutohet dhe vendoset mbi punën që kërkohet apo kostot shtesë që vijnë si rrjedhojë e kushteve të reja.

20.4 Kontraktori menaxhues do të paraqesë propozime mbi bazën e përpjekjeve më të mira, në

lidhje me çdo shpenzim shtesë, në të njëjtat baza si ato të kësaj Kontrate, duke marrë parasysh efektet e ndryshimeve të kostos.

20.5 Në rast se Punëdhënësi vendos ndryshimin e pajisjeve ose të veprimtarisë së tij në përshtatje me kërkesat e reja të punës, Kontraktori menaxhues do të vazhdojë të përmbushë detyrat e tij dhe do të paguhet në përputhje me këtë Kontratë. Në qoftë se ndryshimet do të rezultojnë në ndonjë ndryshim në shërbimet e menaxhimit, atëherë Palët duhet të bien dakord mbi ndikimet e këtyre ndryshimeve.

20.6 Neni 20 në asnjë rast nuk do të interpretohet si një e drejtë që i jepet Kontraktorit menaxhues për të zvogëluar përpjekjet e tij për drejtimin e pajisjeve të Punëdhënësit me maksimumin e aftësive të tij dhe në përputhje me detyrimet sipas kësaj Kontrate.

21. DETYRIMET E SIGURIMIT

21.1 Kontraktori menaxhues do të paguajë dhe mbajë të vlefshme të gjitha sigurimet e kërkuara nga ligji i zbatueshëm në lidhje me punonjësit e AquaMundo-s në Gjermani dhe Shqipëri, gjatë gjithë periudhës së menaxhimit, si dhe:

21.1.1. Sigurimin për palët e treta në një mbulim minimal prej 2.5 milionë (dy milionë e pesëqind mijë) euro për dëmtimet e pronës dhe dëmtimet në persona;

21.1.2. Sigurimin e materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të tij.

21.2 Kontraktori menaxhues do t'i paraqesë Punëdhënësit të gjitha policët e vlefshme të sigurimit para datës së fillimit dhe këto police sigurimi duhet të jenë lëshuar nga një sigures i pranueshëm për Punëdhënësin.

21.3 Në qoftë se Kontraktori menaxhues nuk ka lidhur ose rinovuar ndonjë prej sigurimeve të kërkuara më sipër, atëherë Punëdhënësi duhet të lidhë ose rinovojë këtë policë sigurimi dhe Kontraktori menaxhues do të rimbursojë Punëdhënësin për shumën e primeve të sigurimit.

21.4 Punëdhënësi do të jetë përgjegjës për sigurimin e stafit dhe pajisjeve të Përfituesit, dhe për çdo sigurim tjetër që e konsideron të nevojshëm.

22. TAKSAT DHE TATIMET

22.1 Në bazë të kushteve të Marrëveshjes financiare ndërmjet qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW) për projektin "Furnizimi me ujë, Kavaja II, Manskuria", Punëdhënësi bie dakord të marrë përsipër të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike që rezultojnë jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me shërbimet që do të sigurohen sipas kësaj Kontrate.

22.2 Palët kuptojnë dhe bien dakord që, për qëllimet e kësaj Kontrate, të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike të përmendura në paragrafin 22.1 do të përfshijnë, së paku:

- taksën mbi të ardhurat personale të stafit të huaj, rezident dhe jorezident në Shqipëri;

- TVSH-në mbi çdo të mirë materiale të blerë dhe çdo shërbim të kryer;

- çdo taksë importi dhe tatime të tjera që lidhen të mirat materiale që do të prokurohen ose importohen nga Kontraktori menaxhues dhe/ose shoqëria e tij lokale ligjore, që do të ngrihet sipas paragrafit 15.2;

- taksa mbi fitimin që do të rezultojnë sipas kësaj Kontrate;

- çdo taksë, tatim apo tarifë tjetër që lidhet me sigurimin e shërbimeve sipas kësaj Kontrate.

22.3 Palët bien dakord që kuotimi i çmimit i paraqitur në propozimin financiar të Kontraktorit menaxhues përjashton taksat dhe tatimet.

22.4 Kjo Kontratë menaxhimi do të hyjë në fuqi vetëm pasi Marrëveshja financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW) për projektin "Furnizimi me ujë, Kavaja II, Manskuria" të jetë miratuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe të ketë hyrë në fuqi.

22.5 Punëdhënësi do të përmbushë detyrimet e përjashtimit siç shprehen në Marrëveshjen financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW), për projektin "Furnizimi me ujë, Kavaja II, Manskuria", e cila i bashkëngjitet kësaj Kontrate si shtojca H.

23. PRONËSIA INTELEKTUALE DHE KONFIDENCIALITETI

23.1 Secila nga Palët do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacione të tjera, me shkrim ose me gojë, teknike, financiare apo komerciale, të dhëna nga, ose në emër të Palës tjetër në Kontratë si konfidenciale dhe nuk do t'i botojë ose t'i bëjë ato të njohura për qëllime të tjera nga ato që parashikohen në këtë Kontratë, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër ose në bazë të

kërkesave të ligjeve dhe rregulloreve përkatëse.

23.2 Pavarësisht nga paragrafi 23.1, Kontraktori menaxhues ka të drejtë t'u japë punonjësve të tij, këshilltarëve dhe nënkontraktorëve të gjitha dokumentet dhe informacionin tjetër, siç mund të jetë e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tyre përkatëse. Kontraktori menaxhues nuk do të shkaktojë shkeljen e konfidencialitetit ose lejojë që ndonjë prej këtyre punonjësve, këshilltarëve apo nënkontraktorëve të shkelë konfidencialitetin e ndonjërit prej dokumenteve apo informacionit që ata disponojnë, përveçse kur kjo është e nevojshme për zbatimin e detyrave të tyre.

23.3 Kontraktori menaxhues mundet gjithashtu të përdorë projektin e lidhur me UK Kavajë, sh.a. të akorduar sipas kësaj Kontrate si referencë për qëllime të tjera biznesi, por në asnjë rast një përdorim i tillë nuk do të paraqitet si dëshmi e dhënë nga Punëdhënësi.

24. KALIMI

24.1 Kontraktori menaxhues nuk lejohet t'ia kalojë këtë Kontratë ose të drejtat dhe detyrimet e parashikuara prej saj të tretëve pa miratimin paraprak me shkrim të Punëdhënësit dhe KfW-së.

24.2 Para se të lidhë ndonjë kontratë me individë ose persona juridikë, të cilët mund të kenë lidhje me Kontraktorin menaxhues si shoqëri e kontrolluar apo kontrolluese, personalisht ose me anë të një kontrate bashkëpunimi të përgjithshme, Kontraktori menaxhues duhet të njoftojë Këshillin Mbikëqyrës për ekzistencën e një lidhjeje të tillë. Nëse, sipas gjykimit të Këshillit Mbikëqyrës, kontrata të tilla krijojnë një konflikt interesash, Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të vendosë mosmiratimin e kontratave të tilla.

25. TËRËSIA E KONTRATËS

25.1 Kjo Kontratë dhe dokumentet e treguara në të përbëjnë tërësinë e Kontratës ndërmjet Palëve dhe secila nga Palët pranon se duke rënë dakord dhe duke lidhur këtë Kontratë, ato nuk mbështeten në ndonjë përfaqësim ose garanci, përveç atyre të parashikuara në këtë Kontratë.

26. NJOFTIMET

26.1 Çdo njoftim që do të jepet në lidhje me këtë Kontratë do të jetë me shkrim.

26.2 Përveç njoftimeve ose thirrjeve të bëra në rast të ndonjë padie për mosmarrëveshje apo kundërshti, të ngritur nga ndonjë prej Palëve kundër Palës tjetër në gjykatën kompetente të kësaj Kontrate, të cilat sipas ligjeve procedurale të Republikës së Shqipërisë duhet të bëhen nga vetë gjykata, dërgimi ose dorëzimi i çdo njoftimi sipas kësaj Kontrate do të kryhet me anë të postës rekomande ose faksit në adresën që Pala ka paraqitur në këtë Kontratë apo në çdo adresë tjetër që ajo mund t'i ketë njoftuar Palës tjetër në përputhje me këtë paragraf.

26.3 Çdo njoftim i kryer në lidhje me këtë Kontratë do të konsiderohet si i dhënë:

26.3.1 nëse dorëzohet dorazi, me kusht që të merret një vërtetim i marrjes së tij (firma);

26.3.2 nëse dërgohet me faks, pas kalimit të 2 (dy) orëve nga momenti i dërgimit, nëse dërgohet para orës 15:00 të çdo dite pune dhe në çdo rast tjetër në orën 10:00 në ditën e punës pasuese të ditës së dërgimit, me kusht që një kopje tjetër e plotë të dërgohet me faks në KfW, sa më shpejt të jetë e mundur.

26.4 Për të provuar dërgimin e çdo njoftimi sipas kësaj Kontrate, do të jetë e mjaftueshme që, sipas rastit, të provohet se dorëzimi ishte bërë ose që një letër zyrtare që përmbante njoftimin është dërguar në adresën përkatëse, ose që mesazhi i faksuar ishte adresuar dhe dërguar saktë.

26.5 Njoftimet e dërguara personave të kontaktit që vijojnë më poshtë do të konsiderohen si njoftime të dërguara Palëve:

Punëdhënësi: Pëllumb Vladi
Kryetar
Këshilli Mbikëqyrës i UK Kavajë, sh.a.
Tiranë,
Republika e Shqipërisë
Faksimile: [.....]

Kontraktori menaxhues: Edgar Firmenich
Director Business Development
AquaMundo GmbH
Richard Wagner Str. 75
D-68165 Mannheim

Federal Republic of Germany
Faksimile: 0049-621-40069-333

Për Informacion:
KfW:Kreditanstalt für Wiederaufbau, Dept. L I a/4
Palmengartenstraße 5-9
60325 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Facsimile:0049-69-74 31-34 90

26.6 Palët duhet menjëherë të njoftojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim në adresat apo personat e tyre të kontaktit.

27. MOSUSHTRIMI I TË DREJTAVE DHE DISPOZITA TË TJERA LIGJORE

27.1 Mosushtrimi dhe vonesa në ushtrimin e ndonjë të drejte, autoriteti ose privilegji sipas kësaj Kontrate, nga ana e Punëdhënësit ose e Kontraktorit Menaxhues, nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga ato. Po kështu, nuk do të konsiderohet si heqje dorë ndonjë ushtrim i veçantë ose i pjesshëm i tyre apo ushtrimi i ndonjë të drejte, autoriteti ose privilegji tjetër. Asnjë heqje dorë nga ana e Punëdhënësit ose Kontraktorit menaxhues nuk ka vlerë, nëse nuk është bërë me shkrim.

27.2 Pavarësisht nga dispozita të tjera në këtë Kontratë, Kontraktori menaxhues nuk mban përgjegjësi para Punëdhënësit dhe as Punëdhënësi nuk do të lëshojë një njoftim zgjidhjeje, si rrjedhojë e ndonjë dështimi në përmbushjen e detyrave sipas kësaj Kontrate, kur dhe për sa kohë që një dështim i tillë është pasojë e forcës madhore.

28. PAVLEFSHMËRIA E PJESSHME

28.1 Në rast se ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e ndaluar apo e pazbatueshme në ndonjë juridiksion relevant, ky ndalim ose moszbatueshmëri nuk do t'i bëjnë të pavlefshme edhe dispozitat e tjera të kësaj Kontrate dhe nuk do ta prekin vlefshmërinë e këtyre dispozitave në ndonjë juridiksion tjetër.

29. GJUHA

29.1 Kjo Kontratë dhe gjithë korrespondenca ndërmjet Kontraktorit menaxhues dhe Punëdhënësit, përveç raporteve të përcaktuara nën paragrafin 5.5, do të jetë në gjuhët anglisht dhe shqip. Në rast mospërputhjeje ndërmjet tekstit në anglisht dhe përkthimit, teksti në anglisht do të jetë mbizotërues, përveç rasteve kur korrespondenca niset nga Punëdhënësi, raste në të cilat teksti në shqip është mbizotërues.

30. LIGJI I ZBATUESHËM

30.1 Kjo Kontratë do të drejtohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

31. LISTA E SHTOJCAVE

Shtojcat që vijojnë janë pjesë e kësaj Kontrate menaxhimi.

Shtojca A:

- Certifikata e regjistrimit të shoqërisë UK Kavajë, sh.a.
- Certifikata e regjistrimit të Shoqërisë AquaMundo GmbH
- Statuti i Shoqërisë UK Kavajë, sh.a.
- Autorizimi për nënshkrimin e Kontratës i përfaqësuesve të Punëdhënësit
- Autorizimi për nënshkrimin e Kontratës i përfaqësuesit (ve) të AquaMundo-s

Shtojca B:Ndarja e çmimit total dhe treguesit e ndryshimit të ekonomisë

Shtojca C:Objektivat e punës, kriteret e përmbushjes dhe pagesa e suksesit

Shtojca D:Detyrat e Kontraktorit menaxhues

Shtojca E:Plani i menaxhimit

Shtojca F:Axhenda e stafit dhe plani kohor i Kontraktorit menaxhues

Shtojca G:Propozimi teknik i AquaMundo-s, kapitujt 4, 5, 6, 7, 8.

Shtojca H:Marrëveshja e financimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW), për projektin "Furnizimi me ujë, Kavaja II, Manskuria"

Shtojca I: Modeli i garancisë së pagesës paradhënie

Ne, përfaqësuesit e autorizuar të Palëve, dëshmojmë se e kemi nënshkruar këtë Kontratë në

gjashtë origjinalë, në ditën dhe vitin e përmendur më sipër. Punëdhënësi do të njoftojë brenda 24 orëve Kontraktorin menaxhues për të konfirmuar datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe do t'i dërgojë pa vonesë Kontraktorit Menaxhues një kopje origjinale të Kontratës së nënshkruar.

Organi shtetëror i autorizuar:

Për Ministrinë e Ekonomisë: Për Ministrinë e Rregullimit të
Territorit dhe Turizmit:

Nga: _____ Nga: _____
Aida OsekuBujar Rreme

Tiranë, më 23 dhjetor 2002

AquaMundo GmbH:

Nga: _____
Edgar Firmenich
Drejtore i Zhvillimit të Biznesit

Tiranë, më 23 dhjetor 2002

AMENDAMENTI NR.1 I MARRËVESHJES SË MENAXHIMIT
NËNSHKRUAR MË 23 DHJETOR 2002

Për sigurimin e furnizimit me ujë dhe shërbimet e kanalizimit në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve sh.a.Kavaja, Shqipëri ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë përfaqësuar nga trupi i autorizuar nga shteti dhe AquaMundo GmbH (Kontraktori)

Në zbatim të kushteve të nenit 20, modifikimi dhe rinegociimi i kësaj Marrëveshjeje, Palët e mësipërme nënshkruan Marrëveshjen së menaxhimit bien dakord për amendamentet, korrigjimet dhe sgarimet e mëposhtme:

1. Në tabelën e përmbajtjes, titulli i shtojcës H të lexohet në këtë mënyrë: “Marrëveshja ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë për financimin e projektit “Furnizimi me ujë i zonave rurale, Kavaja II, zona Manskuria”.

2. Faqe nr.3 e Kontratës së menaxhimit, titulli që lexon “Draft i Marrëveshjes së menaxhimit të lexohet: “Marrëveshje e menaxhimit”.

3. Në nenin 22, taksat dhe detyrimet, nënpikat kanë qenë numëruar gabim duke pasur dy nënpika me numrin 22.2. Numri i përgjithshëm i nënpikave është 5 dhe duhet të numërohen pas kësaj nga 22.1 deri në 22.5.

4. Në nenin 22, taksat dhe detyrimet, të gjitha referencat për Marrëveshjen e financimit ndërmjet Kreditansalt fur Wiederaufbau dhe Republikës së Shqipërisë për projektin: “Furnizimin me ujë, Kavaja II, Manskuria” është ndryshuar dhe të lexohet “Marrëveshja midis Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë për financimin e Projektit “Furnizimi me ujë i zonave rurale, Kavaja, II, zona Manskuria”.

5. “Marrëveshja ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë për financimin e projektit “Furnizimi me ujë i zonave rurale, Kavaja II, zona Manskuria” është Marrëveshje financimi në bazë të ligjit nr.9001, datë 13.2.2003, i kaluar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr.13 më datë 14.3.2003.

6. Në nenin 26.5, personi i kontaktit për Punëdhënësin do të jetë:

KRYETARI
Këshilli i Mbikëqyrës i UK Kavajë, sh.a.

Adresë:
Ujësjellës-Kanalizimeve Kavajë.sh.a
Lagja nr.2
Kavajë, Shqipëri

Tel/Fax: ++355 (0)554 2717

7. Në nenin 31, lista e shtojcave, titulli i shtojcës H është ndryshuar dhe të lexohet: “Marrëveshja ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë për financimin e projektit “Furnizimi me ujë i zonave rurale, Kavaja II, zona Manskuria”.

8. Shtojca H tek Marrëveshja e menaxhimit është ligji nr.9003, datë 13.2.2003 siç është kaluar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë.

Të dy Palët janë dakord dhe kanë rënë dakord që amendamentet, korrigjimet dhe sqarimet e mësipërme nuk kanë ndikim material mbi Marrëveshjen origjinale të menaxhimit dhe nuk përbëjnë një ndryshim në përgjegjësitë dhe detyrimet e Kontraktorit të menaxhimit, në mënyrë të tillë që do të kërkonin kompensim shtesë për Kontraktorin e menaxhimit.

Në prani të dëshmitarëve, përfaqësuesit e autorizuar të të dyja Palëve kanë nënshkruar amendamentin nr.1 të Marrëveshjes së menaxhimit me datë 21 prill 2003.

TRUPI I AUTORIZUAR NGA SHTETI

PËR MINISTRINË E EKONOMISË
Nga Aida Oseku

PËR MINISTRINË E RREGULLIMIT TË
TERRITORIT DHE TË TURIZMIT
Nga Bujar Rreme

AquaMundo GmbH:
Nga: Edgar Firmenich
Drejtore i zhvillimit të biznesit